

AGJENDA E KONTRATËS SOCIALE PËR KRYEQYTETIN

HYRJE

Prishtina – në tekstin e mëtejme Kryeqyteti – dhe qytetarët e saj zotohen të zbatojnë Agjendën e Kontratës Sociale të dakorduar nga përfaqësuesit e të dyja palëve për të përmirësuar komunikimin, bashkëpunimin dhe veprimet kolektive përkatëse në mes qytetarëve dhe zyrtarëve të Kryeqytetit.

Objektivat e kësaj Agjende janë:

- të mbështetë bashkëpunimin e hapur, të sinqertë dhe domethënës në mes të zyrtarëve të Kryeqytetit dhe qytetarëve për të zgjidhur çështjet e banorëve;
- të ndihmojë qytetarët dhe zyrtarët komunal që të kuptojnë më mirë përgjegjësitë dhe kontributet e njëri-tjetrit;
- të inkurajojë respektin për diversitetin e përvojave dhe të opinioneve të qytetarëve dhe zyrtarëve publikë; dhe
- të ndërtojë besimin ndërmjet qytetarëve dhe administratës së Kryeqytetit

ZOTIMI PËR PËRMIRËSIMIN E PRAKTIKAVE TË PJESËMARRJES

Korniza ligjore e Kosovës ofron disa mekanizma për pjesëmarrjen publike. Nga një gamë e gjerë e procedurave dhe praktikave në dispozicion, grupet e komunitetit dhe zyrtarët pajtohen të fokusohen në mënyrat në vijim për të përmirësuar pjesëmarrjen publike:

Përdorimi më i madh i kanaleve digjitale të komunikimit

- Kryeqyteti zotohet të përdorë më mirë platformat e medieve sociale, siç është Facebook dhe Instagram, për të komunikuar me qytetarët dhe për t'u angazhuar për çështjet e banorëve. Zyrtarët e Kryeqytetit po ashtu do të përmirësojnë përdorimin e mjeteve konvencionale/tradicionale të informimit për të moshuarit dhe grupet e tjera të popullsisë që nuk janë përdorues të regullit të rrjeteve sociale. Zyrtarët e Kryeqytetit dhe grupet e qytetarëve zotohen të mobilizojnë publikun e gjerë për të shfrytëzuar kanalet ekzistuese të komunikimit. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) zotohen t'i ofrojnë Kryeqytetit rrëfime të suksesi ndërveprimeve konstruktive mes zyrtarëve të Kryeqytetit dhe qytetarëve, në mënyrë që të ky ndërveprim të rritet. Kryeqyteti zotohet të përmirësojë Prishtina Online që të jetë "platformë të integruar dhe miqësore për përdoruesit". Kryeqyteti zotohet të transformojë platformën në një aplikacion celular, duke avancuar "kutinë e saj të bisedave të çastit" dhe duke i integruar aplikacione të ndryshme si Prishtina Parking, transporti publik "Trafiku Urban" dhe *Platforma Digjitale*. Platforma e avancuar do të përmbajë një seksion të dedikuar për ngjarjet e komunitetit, një hartë çiklizmi për adhuruesit e biçikletave që të planifikojnë dhe të shijojnë një turne përreth Kryeqytetit, një seksion ku qytetarët do të mund të raportojnë për çështjet e banorëve në lagje si dhe të gjurmojnë statusin e raportimit të tyre në mënyrë tërësisht transparente, një seksion për Këshillat Lokale, informacione për ndërmarrjet publike, një seksion që shpjegon se si qytetarët mund të angazhohen për të propozuar çështje të banorëve dhe për të votuar për këto çështje në lagje ose fshatra të caktuar, si dhe një seksion të disponueshëm për komentet e qytetarëve për performancën e zyrtarëve të komunës/drejtorive. Kryeqyteti zotohet të organizojë diskutime me grupe fokusi me grupe të ndryshme demografike gjatë procesit të avancimit/ristrukturimit të kësaj platforme të rëndësishme për komunikim digjital. Grupet e qytetarëve dhe këshillat lokale zotohen të ndajnë propozime për ristrukturimin e platformës në grupet e tyre dhe të promovojnë përdorimin e saj nga qytetarët për qëllime të shkëmbimit të informacioneve, për konsultime dhe angazhim me institucionet e komunës. Grupet e qytetarëve zotohen të monitorojnë progresin e avancimit dhe të ndajnë raportet e progresit të arritur me publikun e gjerë përmes grupeve online (grupeve të lagjeve, këshillave lokale dhe faqeve të fshatrave në Facebook). Qendra për Shërbimet për Qytetarët dhe Zyra e Informimit të Publikut zotohen ta promovojnë nismën dhe të kërkojnë komentet e përdoruesit përmes fushatave në medie sociale.
- Kryeqyteti zotohet të krijojë grupe më medie sociale me qytetarë me interesa të përbashkëta (grupe në Facebook për prindërit që kanë fëmijë të vegjël, për biçiklistët, për personat me nevoja të veçanta etj.). Grupet e qytetarëve dhe OShC-të lokale pajtohen të mbledhin

informacione të kontaktit nga anëtarët në rrjetet e tyre dhe të sigurojnë që të jetë dhënë pëlqimi para ndarjes së informacioneve të tyre me zyrtarët e caktuar komunal. Këta zyrtarë zotohen të përdorin grupet në medie sociale dhe në celularë për të ndarë informacionet publike dhe njoftimet përkatëse me grupe specifike të qytetarëve (të rinj, gra etj.) si dhe me banorët e lokaliteteve specifike (p.sh. një fshat ose lagje e caktuar).

- Siç obligohet me ligj, Kryeqyteti zotohet të trajtojë emailt si kërkesa zyrtare dhe t'iu përgjigjet atyre me kohë, fillimisht përmes një mesazhi të përgjigjes automatike. Kryeqyteti zotohet të përmirësojë sistemin e gjurmimit dhe përgjigjes ndaj kërkesave të qytetarëve, duke caktuar një ekip të dedikuar përgjegjës për informimin e qytetarëve për statusin e kërkesave të tyre.

Fuqizimi i Këshillave Lokalë

- Kryeqyteti zotohet të informojë qytetarët dhe OShC-të për ndryshimet në propozimet ekzistuese ose të ardhshme. Kryeqyteti zotohet të organizojë takime me qytetarët për të marrë opinionet e tyre për projekt propozimet, nga të cilat të paktën dy takime duhet të organizohen nga Kryeqyteti. Kryeqyteti zotohet të përdorë mjetet digjitale të komunikimit për të informuar qytetarët. Këshillat lokalë zotohen të prezantojnë informacionet e projekteve para qytetarëve dy herë në vit.
- Në fillim të çdo viti, Kryeqyteti zotohet që të informojë publikisht, përmes medieve sociale, çdo lagje dhe fshat për projektet specifike që planifikohen për atë vit në secilin lokalitet. Kryeqyteti zotohet të informojë këshillat lokalë dhe grupet e qytetarëve brenda çdo lagje dhe fshati për projektet e planifikuara, specifike për atë zonë, me shkrim me email. Këshillat lokalë zotohen t'u prezantojnë këto projekte të planifikuara anëtarëve të komunitetit të tyre. Në këmbim, përfaqësuesit e këshillave lokalë zotohen të ndajnë informacionet me komunitetet e tyre përkatëse.
- Kryeqyteti zotohet të marrë parasysh të gjitha kërkesat e Këshillave Lokalë të diskutuara gjatë dëgjimeve buxhetore dhe të njoftojë kryetarët e tyre për statusin e kërkesave. Kryeqyteti zotohet të krijojë një bazë të dhënash ku kërkesat e qytetarëve dhe përgjigjet e komunës për ato kërkesa të gjurmohen. Këshillat Lokalë zotohen të promovojnë dëgjimet buxhetore duke informuar komunitetin dhe duke ia dorëzuar kërkesat Kryeqytetit në emër të grupeve/lagjeve të tyre.
- Kryeqyteti zotohet të identifikojë grupet joformale të lagjeve, duke përfshirë grupet e apartamentve në ndërtesat kolektive, dhe t'i përfshijë në konsultime publike në të njëjtën mënyrë siç përfshin këshillat lokalë. Zyrtarët e Kryeqytetit zotohen të konsultohen me kryetarët e këshillave lokalë dhe grupet e lagjeve para p dëgjimeve publike për të lejuar kohë të mjaftueshme që të marrin komentet, dhe duke promovuar e paralajmëruar takimin me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes së qytetarëve. Grupet e lagjes zotohen t'u përgjigjen ftesave nga komuna dhe të marrin pjesë në konsultimet dhe përgatitjet para takimeve publike.
- Kryeqyteti zotohet të ndërmerret masa afirmative për ta bërë më tërheqës angazhimin e qytetarëve dhe zotohet të prezantojë shpërblime të komunitetit siç janë "Shpërblimi për lagjen më të pastër" dhe "Grupi i lagjes/Këshilli lokal më aktiv" për të vlerësuar kontributin e qytetarëve për zgjidhjen e çështjeve të banorëve. Grupet e qytetarëve dhe OShC-të lokale zotohen të organizojnë nisma vullnetare që kontribuojnë në përmirësimin e lagjes dhe komunitetit të tyre. Këshillat lokalë dhe grupet e qytetarëve zotohen po ashtu të promovojnë dhe të garojnë për këto shpërblime të iniciuara nga Kryeqyteti.

Dëgjimet publike gjithë përfshirëse

- Kryeqyteti zotohet të organizojë diskutime tematike për tema specifike të interesit për grupet e popullsisë që rrallë marrin pjesë në diskutime publike, siç janë rinia, personat me nevoja të veçanta, të moshuarit, gratë dhe përfaqësuesit nga komunitetet joshumicë. Për të mbuluar këto grupe të popullsisë, Kryeqyteti zotohet të bashkëpunojë me persona dhe organizata që janë pjesë e rrjeteve të ndryshme, p.sh. me liderët e komunitetit, kryetarët e shoqatave të lagjeve, këshillat e fshatrave dhe OShC-të. Grupet e qytetarëve zotohen të informojnë kolegët e tyre, miqtë dhe familjen për këto diskutime dhe të shpërndajnë informacionet brenda rrjeteve të tyre për të siguruar pjesëmarrje më të madhe të qytetarëve në këto takime. Kryeqyteti zotohet të planifikojë takime të paktën tetë ditë kalendarike para dhe të postojë orarin në uebfaqen e Kryeqytetit dhe tabelat e njoftimeve të paktën 14 ditë kalendarike para takimeve.

- Kryeqyteti dhe grupet e qytetarëve zotohen të eksplorojnë buxhetimin me pjesëmarrje si element të ciklit të ardhshëm të përgatitjes së buxhetit. Kryeqyteti zotohet të organizojë punëtori të buxhetimit me pjesëmarrje dhe të alokojë një përqindje të fondeve për zgjidhjen e çështjeve të banorëve të identifikuar bashkërisht me qytetarët. Kryeqyteti zotohet të alokojë një 0.5 për qind të tavanit buxhetor për zbatimin e projekteve të komunitetit të vendosur përmes të procesit të buxhetimit me pjesëmarrje.
- Kryeqyteti zotohet të trajnojë drejtorët dhe zyrtarët përkatës për lehtësimin e dëgjimeve publike dhe për ngjarje të tjera komunale. Trajnimi duhet të përfshijë sesione për teknikat e lehtësimit dhe të ofrojë udhëzues të standardizuar të lehtësimit (po ashtu një listë të kontrollit për planifikimin, organizimin dhe menaxhimin e ngjarjeve publike), si dhe shabllonet për raportimin për konsultimet publike. Grupet e qytetarëve zotohen të ofrojnë komentet për listën e kontrollit dhe për udhëzuesin, ndërsa OJQ-të më me përvojë do të ofrojnë njohuritë dhe shkathësitë e tyre për lehtësimin e ngjarjeve të konsultimit.

Rritja e informimit publik dhe promovimi i komunikimit përfshirës

- Kryeqyteti zotohet të zhvillojë strategji të detajuar të komunikimit, e cila do të përfshinë konferenca mujore për gazetarë, ku Kryetari i Kryeqytetit shpjegon proceset për planet e propozuara për lagje të ndryshme. Qytetarët kërkojnë që të shfrytëzohen më shumë televizionet për të transmetuar informatat për çështjet e lidhura për ngjarjet dhe zhvillimet në Kryeqytet.
- Kryeqyteti zotohet të hulumtojë sektorin privat për mundësitë për të kontraktuar shërbimet siç janë komunikimi dhe informimi. Grupet e qytetarëve dhe OJQ-të zotohen të shpërndajnë informatat brenda rrjeteve të tyre për të promovuar angazhim sa më të gjerë të qytetarëve. Kryeqyteti zotohet të përdorë burimet e veta të TI-së për të promovuar praktikat më të mira të komunikimit dhe të shpërndarjes së informacioneve, sidomos përmes rrjeteve sociale.
- Kryeqyteti zotohet të vë në dispozicion të gjitha informacionet zyrtare në të gjitha gjuhët zyrtare sipas kërkesave ligjore. Zyrtarët e kryeqytetit zotohen të komunikojnë në një mënyrë që është lehtë e kuptueshme nga të gjithë qytetarët. Kryeqyteti zotohet të përdor grafikë informative për të ilustruar proceset dhe informacionet e tjera që ato të jenë lehtë të kuptueshme nga qytetarët. Dhe në fund, Kryeqyteti zotohet të bëjë njoftime publike koncize dhe të lehta për t'u lexuar, dhe të elaborojë lidhur me terminologjinë e që shpesh nuk kuptohet saktësisht nga masat e gjëra të shoqërisë.

ÇËSHTJET E BANORËVE QË DUHET TË ADRESOHEN BASHKËRISHT NGA QYTETARËT DHE ZYRTARËT E KRYEQYTETIT

Përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrtarët publikë të Kryeqytetit kanë identifikuar dhe kategorizuar bashkërisht listën vijuese të çështjeve të banorëve.

I. ZGJERIMI DHE SHENJËZIMI I SHTIGJEVE TË ECJES NË PARKUN E GËRMISË

Përshkrimi i problemit

Parku i Gërmisë është zona e vetme rekreative e Prishtinës ku qytetarët mund të shëtisin në këmbë, me biçikletë, mund të vrapojnë dhe të shijojnë natyrën e së bashku me familjen . Parku përfshinë 45 km shtigje; megjithatë, ato nuk mirëmbahen rregullisht dhe nuk ka shenja ose tabela për orientim të lehtë. Për më shumë, ka vetëm një hyrje zyrtare në Parkun e Gërmisë që krijon ngarkesë trafiku, sidomos gjatë fundjavave. Qytetarët e Prishtinës nga zonat periferike udhëtojnë me makinë për të hyrë në Parkun e Gërmisë. Me këtë intervenim planifikohet të krijohen gjithsej 90 km shtigje të qasshme me lehtësi nga katër anë të Prishtinës që do t'u mundësonte qytetarëve nga zonat periferike të qasen më lehtë në park më këmbë dhe me biçikletë. Gjithashtu, me këtë intervenim do të vendosen shenjat e duhura në shtigje dhe do të dizajnohet një hartë digjitale miqësore për përdoruesin që paraqet të gjitha shtigjet e disponueshme në park.

Objektivi

Objektivi i këtij intervenimi është që komuniteti që mbështet aktivitetet në natyrë, që banorët e katër lokaliteteve të afërta dhe institucionet e Kryeqytetit të punojnë së bashku për promovimin e turizmit të bazuar në natyrë të fokusuar në politika miqësore për mjedisin dhe shprehi të shëndetshme.

Plani i veprimit për zgjidhjen e çështjes

Identifikimi i nevojave

1. Shoqata “Klubi Alpin” dhe shoqatat e tjera rekreative dhe mjedisore do të punojnë për të përgatitur dhe për t’i ofruar një plan draft për zbatimin e propozimit Drejtorisë së Parqeve dhe Drejtorisë së Shëndetit Publik.
2. Zyrtarët e këtyre dy drejtorive do të rshqyrtojnë propozimin dhe do të ofrojnë komente dhe opinionin e eksertëve për mundësinë e zbatimit..
3. Shoqatat do të zgjedhin përfaqësues (p.sh. alpinistët, biçiklistët) në mënyrë transparente dhe të drejtë, i/e cil/ai do të takohet me zyrtarët për të diskutuar aktivitetet plotësuese që të dyja palët do të zbatojnë për të mirën e qytetarëve.
4. Përfaqësuesit e shoqatave do të takohen me zyrtarët e Kryeqytetit për të diskutuar opsionet dhe alternativat e propozimeve që do të mund të zbatohen dhe t’u prezantohen qytetarëve.
5. Kryeqyteti do të publikon hartat e shtigjeve të propozuara. Bashkë me komunitetin, Kryeqyteti do të fillon seri diskutimesh publike të prezantojnë planet duke përdorur grafika të thjeshtë statistikore, grafika informativë dhe video që janë lehtë të kuptueshme nga publiku i gjerë.
6. Pas finalizimit të procesit të konsultimeve dhe arritjes së pajtimit për shtigjet, shenjëzimin dhe hartën digjitale, shoqatat dhe zyrtarët e Kryeqytetit do ta publikojnë dhe promovojnë projektin final.

Hartimi i planit të shtigjeve të Gërmisë

7. Kryeqyteti publikon hartat e shtigjeve dhe shenjëzimet e propozuara (p.sh. për ciklizëm, shëtitje në natyrë me familjen, aktivitete shëndetësore etj.). Kryeqyteti do të përfshijë shtegun për personat me shikim të dëmtuar por si pjesë e një projekti më të gjerë.
8. Bashkë me shoqatat, Kryeqyteti nisë serinë e dëgjimeve publike, duke filluar nga muaji shkurt 2023, ku zyrtarët dhe përfaqësuesit e komunitetit prezantojnë planet duke përdorur grafikë të thjeshtë statistikore, grafikë informativë dhe video që janë lehtë të kuptueshme nga publiku i gjerë. Qyteti dhe përfaqësuesit e komunitetit do të mbajnë dëgjime publike në komunitetet kur do të prezantohen shtigjet e reja (Mat, Hajvali, Vranjevc dhe Mramor)..
9. Kryeqyteti do të ftojë qytetarët të marrin pjesë në diskutime të paktën tetë ditë para ngjarjes dhe poston informacionet në uebsajtin zyrtar të Kryeqytetit, në tabelën e njoftimeve dhe rrjetin zyrtar të medie sociale, së paku 14 ditë para takimit. Për më shumë, Kryeqyteti do t’i ftojë qytetarët edhe përmes grupeve të Viber/WhatsApp, Facebook, Instagram, si dhe do të zhvillojë anketa të shkurtra të opinionit publik ku qytetarët mund të votojnë për për shtigjet e referuara si p.sh. sheshet, shkollat, parqet e lagjes etj. Kryeqyteti integron komentet e qytetarëve gjatë konsultimeve publike.
10. Kryeqyteti do të punojë për përmirësimin e bashkëpunimit dhe komunikimit me qytetarët. Qytetarët do të informohen për ngjarje të ndryshme dhe probleme që lidhen me shtigjet (p.sh., përmblytjet e ndonjë pjese të shtigjeve, moti i ashpër). Qytetarët dhe zyrtarët e Kryeqytetit do të takohen në baza tremujore për të raportuar për progresin e projektit. Qytetarët zotohen që pas secilit takim, të informojnë për procesin dhe progresin e arritur.
11. Zyrtarët e Kryeqytetit dhe shoqatat do të inkurajojnë bizneset private dhe qytetarët që të sponsorizojnë/mbështetin elemente shtesë në park si stolat në vendet për pushim, pemët, zonat e gjelbra, lulet etj.

Palët e interesit

Të gjitha grupet e qytetarëve të interesuar për promovimin e jetesës së shëndetshme dhe hapësirave publike miqësore për mjedisin do të përfitojnë nga ky intervenim. Palët e tjera të interesit përfshijnë klubet sportive, drejtoritë përkatëse, shoqatat e pensionistëve, shkollat (që mund të organizojnë aktivitete në natyrë me fëmijët), artistët, mbrojtësit e mjedisit, OShC-të lokale me anëtarë siç janë Shoqata e Biçiklistëve, Shoqata e Arkitektëve, Klubet Alpine etj.

Praktikat që do të aplikohen për zgjidhjen e çështjes

- **Dëgjimet publike gjithëpërfshirëse.** Bashkë me shoqatat, Kryeqyteti do të nisë seri dëgjimesh publike, duke filluar nga muaji shkurt 2023, ku zyrtarët dhe përfaqësuesit e komunitetit prezantojnë planet e tyre duke përdorur grafikë të thjeshtë statistikore, grafikë informativë dhe video që janë lehtë të kuptueshme nga publiku i gjerë. Qyteti dhe përfaqësuesit e komunitetit do të mbajnë dëgjime publike në komunitetet kur do të prezantohen shtigjet e reja (Mat, Hajvali, Vranjevc dhe Mramor), si dhe me publikun e gjerë. Këto dëgjime do të shërbejnë si forume për të diskutuar nismën dhe për të informuar qytetarët për llojin përkatës të punës, angazhimin dhe pajisjet që do të përdoren ose instalohen (dritat, numri i kontaktit për rastet e urgjencës, hartat, shenjat orientuese etj.).
- **Këshilla lokale më të fuqishme.** Drejtoritë e Parqeve dhe Shëndetësisë dhe shoqatat e përfshira në zhvillimin e idesë fillestare do të përfshijnë kryetarët e Këshillave Lokale të në procesin e konsultimeve për katër lokalitet ku shtigjet e Gërmisë do të zgjerohen. Kryetarët e këshillave lokale do të ofrojnë inputin e tyre për mirëmbajtjen e shtigjeve.
- **Përdorimi më i madh i kanaleve digjitale të komunikimit**
 - Drejtoritë do të krijojnë grupe në Viber/WhatsApp duke përdorur kontaktet nga grupe të ndryshme të anëtarëve për t'i informuar ata paraprakisht për propozimin dhe mundësinë për të ofruar inputin e tyre përmes dëgjimeve publike. Zyrtarët e Kryeqytetit po ashtu do të përdorin kanalet e medieve sociale për të publikuar planin e propozuar dhe hartën e shtigjeve për të marrë komentet e qytetarëve për propozimin më të mirë.
 - Zyrtarët e Kryeqytetit, në bashkëpunim me shoqatat, do të zhvillojnë njoftim publik për ta promovuar këtë nismë. Zyrtarët e Kryeqytetit do të përgatën për planifikimin dhe organizimin e dëgjimeve publike, duke përdorur udhëzuesin për lehtësim, grafikë informativë dhe video për të informuar më mirë qytetarët për planet për atë zonë.

2. PËRMIRËSIMI I KUSHTEVE TË KOPSHTIT ME BAZË NË KOMUNITET “BOTANIKA” NË MATIQAN

Përshkrimi i problemit

Kopshti me bazë në komunitet “Botanika”, gjendet në një nga lagjet më të mëdha periferike të qytetit të Prishtinës. Në vitin 2014, komuniteti lokal dhe Kryeqyteti nisën idenë e themelimit të kopshteve me bazë në komunitet dhe administrata e Kryeqytetit identifikoi objektet publike ku do të vendoseshin këto kopshte. Kryeqyteti ofroi trajnime për edukatorët, mobilie, lodra, materiale shkollore dhe materiale mësimi oi dhe duke ndarë buxhet për pagat e personelit. Në Kryeqytet ka shumë kopshte private; megjithatë, numri i prindërve që mund të përballojnë pagesën e kostove mujore është i kufizuar. Për këtë arsye, Kryeqyteti vendosi të kontribuojë me deri në 50 për qind të pagave të edukatoreve, me prindërit që mbulojnë kostot e mbetura. Kjo nismë u lejoi më shumë prindërve të dërgonin fëmijët e tyre në kopsht duke ulur koston. Në këmbim, kjo po ashtu krijoi më shumë mundësi, sidomos për gratë, që të marrin pjesë në tregun e punës pa qenë e nevojshme të shqetësohen për organizimin e kujdesit për fëmijët.

Prindërit, edukatorët dhe drejtorja e kopshtit zhvilluan disa projekte dhe morën mbështetje nga donatorët për të mirëmbajtur objektet e shkollës. Megjithatë, kopshti ka nevojë për përmirësime shtesë si dhe mjete mësimore për aktivitete për të mbështetur zhvillimin krijues të fëmijëve. Për shembull, shoqata e prindërve dhe personeli i kopshtit identifikuan nevojën për të rinovuar nyjet ekzistuese sanitare, dyshemenë e kopshtit dhe furnizimin me lodra dhe mjete edukative.

Objektivi

Objektivi i këtij intervenimi është krijimi i praktikave të mira të bashkëpunimit në mes komunitetit, këshillit të kopshtit, shoqatës së prindërve dhe zyrtarëve të Kryeqytetit për të përmirësuar kushtet fizike të kopshtit dhe për të ofruar materialet e nevojshme edukative.

Plani i veprimit për zgjidhjen e çështjes

Përcaktimi i rrjedhës së veprimit

1. Grupi kyç i përfaqësuesve të komunitetit do të mbajë një takim të komunitetit me këshillin e kopshtit me bazë në komunitet “Botanika”, prindërit dhe mësimdhënësit e komunitetit për të diskutuar përmirësimet ekzistuese fizike të kopshtit dhe furnizimin e tyre me mjetet mësimore.

2. Këshilli i kopshtit me bazë në komunitet do të shpallë nismën në faqen e kopshtit në Facebook dhe do të organizojë ushatë për të marrë ide dhe komente për këtë nismë.
3. Grupi i qytetarëve, prindërve dhe zyrtarëve të Kryeqytetit do të bëjnë bashkërisht një analizë të detajuar të nevojave për rinovim.
4. Personeli i kopshtit do të ofrojë listë të detajuar të furnizimeve dhe lodrave të nevojshme për kopshtin në fillim të vitit 2023, që do të ndahet me Drejtorinë e Arsimit.
5. Kryeqyteti do të shqyrtojë kërkesat për përmirësime dhe specifikimet teknike sipas standardeve. Kryeqyteti do të shpallë thirrje për të gjithë qytetarët e interesuar për të aplikuar që të bëhen pjesë e komitetit të vlerësimit.
6. Ftesa publike do t'u dërgohen të gjithë prindërve të interesuar të marrin pjesë në punën e komitetit dhe në procesin e vlerësimit të të gjitha ofertave të marra nga kompanitë përmes procesit të prokurimit.
7. Kryeqyteti do të angazhojë këshillin e prindërve dhe menaxhmentin e kopshtit "Botanika" në monitorimin e zbatimit të kontratës, duke i përfshirë në tërë procesin që nga kontraktimi e deri tek finalizimi.
8. Zyrtarët e Kryeqytetit dhe shoqatat do t'u dërgojnë ftesa grupeve të lagjeve të afërta për të marrë pjesë në monitorimin e procesit të zbatimit.
9. Pas përfundimit të procesit të rinovimit, Kryeqyteti dhe këshilli i kopshtit do të organizojnë ceremoni inauguruese dhe do të dërgojë ftesa qytetarëve të lagjeve të afërta. Në ceremoninë inauguruese, qytetarët do të prezantojnë perspektivën e tyre lidhur me atë se si ishte të bashkëpunonin me Kryeqytetin gjatë zbatimit të këtij aktiviteti.
10. Grupet e qytetarëve zotohen të punojnë me këshillin e kopshtit për të mbuluar kostot e mirëmbajtjes së pajisjeve dhe përmirësimeve të bëra në kuadër të kësaj nisme.

Palët e interesit

Zyrtarët e Kryeqytetit, Këshillat Lokalë, këshillat e prindërve dhe grupet e qytetarëve, edukatorët e kopshtit dhe fëmijët.

Praktikat që do të aplikohen për zgjidhjen e çështjes

- **Fuqizimi i Këshillave Lokalë.** Kryetari i këshillit lokal të Matiqanit do të angazhohet në këtë nismë që nga fillimi, përmes vlerësimit të nevojave dhe monitorimit të zbatimit. Kryetari i këshillit lokal po ashtu do të angazhohet në diskutimet në mes komunitetit, këshillit të kopshtit dhe Drejtorisë e Arsimit.
- **Dëgjimet publike gjithëpërfshirëse.** Kryeqyteti do të organizojë konsultime me komunitetin për të marrë inputin e tyre për përmirësimet e nevojshme. Për më shumë, Drejtorja e Arsimit do të nisë një diskutim me udhëheqësit e komunitetit për të përcaktuar financimin dhe mirëmbajtjen e kopshtit në të ardhmen.
- **Përdorimi më i madh i kanaleve digjitale të komunikimit.** Drejtorja e kopshtit dhe edukatorët zotohen të mbështetin këtë nismë dhe të publikojnë zotimet e tyre në faqen e kopshtit në Facebook. Bashkërisht, do të organizojnë fushatë rreth kësaj nisme për të marrë idetë dhe komentet e pjesëtarëve të komunitetit për këtë nismë.

Agjenda e Kontratës Sociale u dakordua nga zyrtarët e Kryeqytetit dhe 23 përfaqësues të komunitetit në një proces të lehtësuar dhe të mbështetur nga Aktiviteti i USAID-it "Kontrata Sociale" gjatë periudhës gusht - nëntor 2022. Zyrtarët e Kryeqytetit dhe përfaqësuesit e komunitetit zotohen të zbatojnë veprimet e sipërpërmendura brenda një periudhe prej 18 muajsh. Zyrtarët e Kryeqytetit dhe grupet e qytetarëve zotohen të takohen në baza tremujore për të monitoruar progresin e kësaj Agjende të Kontratës Sociale.